

URDHËR
Nr. 49, datë 30.4.2012

**PËR MIRATIMIN E RREGULLORES “MBI KUSHTET DHE METODAT E PËRDORIMIT
TË DELTAPLANEVE DHE PARASHUTAVE”**

Në mbështetje të nenit 102 pika 4 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë dhe ligjit nr.10 040, datë 22.12.2008 “Kodi Ajror i Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar, me ligjin nr. 10 484, datë 24.11.2011,

URDHËROJ:

1. Miratimin e rregullores “Mbi kushtet dhe metodat e përdorimit të deltaplaneve dhe të parashutave”, sipas tekstit dhe shtojcave përkatëse që i bashkëlidhen këtij urdhri dhe janë pjesë përbërëse e tij.
2. Ngarkohet Autoriteti i Aviacionit Civil të Republikës së Shqipërisë për zbatimin e këtij urdhri.
3. Ky urdhër hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

MINISTRI I PUNËVE PUBLIKE DHE TRANSPORTIT
Sokol Olldashi